

# AKTI I THEMELIMIT

## I SHOQERISE TREGETARE "IKONA" sh.p.k.

### Neni 1

Me vullnetin e lire te Ortakut te vetem Lefter Sota, i biri i Panajotit, i datl. 19.9.1956, lindur ne Risili dhe banues ne Vlore, themelohet Shoqeria Tregtare "Ikona" sh.p.k.

### Neni 2

Shoqeria do t'a kete seline e saj ne Lagjen "11 Janari", prane ish magazinave te ullirit te qytetit te Vlores, por me vendim te ortakut te vetem mund te ngrihen edhe dege, filiale apo edhe seli ne vende te tjera.

### Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete per 10 vjet, por me vendim te ortakut te vetem ky afat mund te zgjatet ose shoqeria mund te prishet para kohe.

### Neni 4

Kapitali themeltar i Shoqerise perbehet nga 500.000 leke, i cili eshte teresisht kapital financiar dhe i depozituar ne banke ne emer te saj.

I gjithë kapitali themeltar zoterohet nga Ortaku i Vetem Lefter Sota, i cili ka te drejte t'a tjetersoje kete kapital, te shtoje apo pakesoje kuotat e kapitalit deri ne kufijte e percaktuar nga ligja.

### Neni 5

Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete:

Tregtimi me shumice dhe me pakice i mallrave industriale si produkte metalurgjike, celiqeve, metaleve me ngjyra, materialeve te ndertimit, materialeve hidraulike, qeramikes, hidrosanitare, elektroshtepiake, xhamave, prodhimeve prej druri dhe materialeve elektrike. Shitja, rishitja, importimi, eksportimi dhe riekportimi i tyre, brenda dhe jashte vendit.



Shoqeria mund te bashkpunoje edhe me shoqeri te tjera qe kane object veprimtarie te njejte ose te ngjashem me te.

#### Neni 6

Organi i vetem drejtues i Shoqerise eshte Ortaku i Vetem Lefter Sota,i cili eshte dhe administrator i saj.


#### Neni 7

E gjithë veprimtaria e Shoqerise do te bazohet ne ligjin Nr.7638,date 19.10.1992"Per shoqerite tregetare"si dhe ne legjislacionin ne pergjithsi te Republikes se Shqiperise.

#### Neni 8


Ky Akt Themelimi u nenshkrua ne te pese kopje e barazvlereshme te tij sot me date 26.08.2002.

ORTAKU I VETEM  
LEFTER SOTA



.....  
REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA VLORE


Nr. 1119 red.  
Nr. 753 kol.  
Vlore, me 26.03.2000



#### VERTETIM

Me te cilin vertetoj se Ortaku i vetem Lefter Sota,i biri i Panajotit,i datlindjes 19.9.1956,lindur ne Risili te Vlores,person madhor,me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar,i identifikuar prej meje sipas ligjit,u paraqit para meje noteres dhe e nenshkroi Aktin e Themelimit te Shoqerise "Ikona" sh.p.k.me vullnetin e tij te lire dhe ne pranine time.Pas kesaj une noterja e vertetova dhe e regjistrova.

NOTERJA



# STATUTI

## I SHOQERISE TREGETARE "IKONA" Sh.p.k.

### Neni 1

Me vullnetin e lire te Ortakut te Vetem Lefter Sota, eshte themeluar shoqeria tregetare me emrin "IKONA" sh.p.k.

### Neni 2

Shoqeria do t'a kete seline e saj ne Lagjen "11 Janari", prane ish magazinave te ullirit te qytetit te Vlores, por me vendim te ortakut te vetem mund te ngrihen edhe dege, filiale apo edhe seli ne vende te tjera.

### Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete per 10 vjet, por me vendim te ortakut te vetem ky afat mund te zgjatet ose shoqeria mund te priset para kohe.

### Neni 4

Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete:

Tregetimi me shumice dhe me pakice i mallrave industriale si produkte metalurgjike, celiqeve, metaleve me ngjyra, materialeve te ndertimit, materialeve hidraulike, te qeramikes, hidrosanitare, elektroshtepiake, xhamave, prodhimeve prej druri dhe materialeve elektrike. Shitja, rishitja, importimi, eksportimi dhe riekportimi i tyre, brenda dhe jashte vendit.

Shoqeria mund te bashkpunoje edhe me shoqeri te tjera qe kane object veprimtarie te njejte ose te ngjashem me te.

### Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqerise perbehet nga 500.000 leke, i cili eshte teresisht kapital financiar dhe i depozituar ne banke ne emer te saj.

I gjithe kapitali themeltar zoterohet nga Ortaku i Vetem Lefter Sota, qe ka te drejte t'a tjetersoje kete kapital, te shtoje apo pakesoje kuotat e kapitalit deri ne kufijte e percaktuar nga ligja.



Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 pjese(kuota) me vlere 5.000 leke sejcila kuote.

#### Neni 6

Organi i vetem drejtues i Shoqerise eshte Ortaku Lefter Sota,i cili eshte dhe administrator i saj.

#### Neni 7

Ortaku i vetem perfaqeson Shoqerine ne mardhenie me te tretet,nenshkruan ne emer te saj te gjitha aktet qe kane te bejne me veprimtarine e Shoqerise,ka te drejten e perfaqesimit gjyqesor dhe eshte firme e vetme e saj ne banke.

#### Neni 8

Kompetencat e Ortakut te Vetem te Shoqerise barazohen me kompetencat qe me ligj i takojne Asamblese se Ortakeve:

Miraton Statutin dhe ndryshimet ne te.

Miraton bilancet.

Emeron administratorin ose keshillin administrativ.

Vendos per ndarjen e te ardhurave,pjesmarjen ne shoqeri te tjera,shkrirjen e Shoqerise para kohe,zgjatjen e afatit maksimal te veprimtarise se Shoqerise, hapjen e filialeve te Shoqerise ne vende te tjera si dhe per ceshtje te tjera qe me ligj i takojne Asamblese se Ortakeve.

#### Neni 9

Ortaku i vetem i Shoqerise mund te perfaqesohen nga persona te trete te besuar prej tij,gjithmone brenda kufijve ligjor dhe me prokure te leshuar sipas ligjit.

Funksionet administrative te jashtezakoneshme nuk mund te transferohen.

#### Neni 10

Veprimtaria vjetore e Shoqerise mbyllet ne 31 Dhjetor te cdo viti.



## Neni 10

Ne perfundim te mbylljes se bilancit Ortaku i Vetem percakton menyren e shperndarjes se fitimit,likujdimin e detyrimeve dhe percakton rezerven ligjore,e cila si rregull nuk mund te jete me e vogel se 5 perqind te fitimit te realizuar.

## Neni 13

Me mbarimin e afatit te caktuar,Shoqeria shperndahe dhe Ortaku i vetem do te caktoje nje ose disa likujdatore,te cilet ne baze te ligjit do te realizojne shkrirjen e Shoqerise.

## Neni 14

Shoqeria mund te priset para kohe:

-Me vendim te Ortakut te Vetem.

-Pas dy vjeteve te veprimtarise me bilanc negativ.

## Neni 15

E gjithë veprimtaria e Shoqerise do te bazohet ne ligjin Nr.7638,date 19.10.1992"Per shoqerite tregtare"si dhe ne legjislacionin ne pergjithsi te Republikes se Shqiperise.

## Neni 16

Shoqeria do te kete vulen dhe siglen e saj.

Ky Statut u nenshkrua sot me date 7.8.2002 ne te pese kopjet e barazvlereshme te tij.

ORTAKU I VETEM  
LEFTER SOTA

